

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, sipas gjyqtarit Halil Zahiri, me s. juridike, Xhenita Ramadani, në çështjen juridike të paditësit, Sh.K, nga Gj, rr. nr. ndaj të paditurave, M. për në P e përfaqësuar prej avokates shterore, N. K, nga Prishtina dhe NN „B.B „, me seli në Gjilan, sipas të autorizuarit, R.K jurist, nga Gj, për kompensimin e dëmit, në shqyrtimin kryesorë dhe publik të mbajtur më dt.06.03.2017 bie këtë

## A K T G J Y K I M

**I. REFUZHET si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit, Sh. K, nga Gi, ndaj të paditurave, dhe NN „B.B „, me seli në Gjilan, për kompensimin e dëmit material në lartësi prej 1.301,00 €, në mungesë të provave.

**II.** Në bazë të nenit 450, gjykata vendosi që sejcila palë ti bart shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

## A r s y e t i m

Paditësi, Sh. nga Gj, në padi-kërkesëpadi kan konfirmuar se të paditurat, gjat punëve të kryera në vitin 2015 për drejtimin e lumit, në parcelat nr. ..dhe parcelaën.., i kan shkakatuat dëmin paditësit, në kuktura bujqësore të kopshtarisë dhe ia kishin bërë të pamundur punimin e kopshtarisë, në parcelat ekzistuese, të cilat parcela paditësi i ka patur në pronësi, për çka në pamundësi të punoi në vitin 2015 paditësi nuk ka mundur të punoi tokën për mjelljen e kulturave bujqësore dhe për këtë iu ka shkakatuat dëmi në lartësinë prej 1.301,00 €.

*Paditësi ka deklaruar se nuk ka kurfar kontrate apo autorizim si provë për të dëshmuar se ishte pronar juridik dhe faktik apo shfrytëzues, i parcelave të cekura si më lart, e nëse gjykata e kërkon mundet ta bëj ndonjë kontratë për vitin 2017.*

Në seancën kryesore të mbajtur më dt. 06.03.2017, paditësi kishte deklaruar se qëndroi pran padisë-kërkespadi së dhe i propozoi gjykatës të lexohen dhe administrohen të gjitha provat nga lënda dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata të bie aktgjykim me të cilin në tërësi ta aprovoi kërkespadi në e paditësit dhe ti detyroi të paditurat t ia kompensoi dëmin material në lartësinë prej gjithësejt 1.301,00 €.

E paditura, e përfaqësuar prej avokates shterore, N. K, nga P në seancën kryesore të mbajtur më dt. 06.03.2017, deklaroi se qëndroi pran përgjigjes në padi të ushtruar kësaj gjykate dhe se paditësi nuk ka legjitimitet real aktivë në këtë çështje kontestuese, për faktin se nuk ka prova për ta dëshmuar pronësinë ndaj parcelave të cekura më lart, andaj i propozoi gjykatës që ta refuzoi në tërësi kërkespadi në e paditësit për kompensimin e dëmit si të pabazuar.

E paditura, NN „B.B., me seli në Gj sipas të autorizuarit, R. K jurist, nga Gj në seancën kryesore të mbajtur më dt.06.03.2017, deklaroi se qëndroi pran përgjigjes në padi të ushtruar kësaj gjykate dhe se paditësi nuk ka legjitimitet real aktivë në këtë çështje kontestuese, për faktin se nuk ka prova për ta dëshmuar pronësinë ndaj parcelave të cekura më lart, andaj i propozoi gjykatës që ta refuzoi në tërësi kërkespadi në e paditësit për kompensimin e dëmit si të pabazuar.

Palët ndërgjyqëse i propozojnë gjykatës të lexohen dhe administrohen të gjitha provat nga lënda.

Në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata i ka lexuar dhe administruar të gjitha provat nga lënda si vijoi:

- Shiqohen dhe administrohen, 2. foto kolor, të madhësisë 10x20 cm, 5. foto kolor, të madhësisë 15x30 cm dhe 9. foto kolor të formatit A4, nga këto foto shiqohet përshkrimi i terrenit dhe lumit .

- Lexohet dhe administrohet, Aktvendimi, .., i dt.21.01.2015, nga Gjkata Themelore në Gjilan. Nga kjo provë gjykata konstatoi se është refuzuar kërkespadi e paditësit Sh.K, nga Gjilani, për pengi posedimi.

- Lexohet dhe administrohet, A.., i dt.08.06.2015, nga Gjkata e Apelit, në Prishtinë. Nga kjo provë gjykata konstatoi se është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktvendimi, ...i dt.21.01.2015, nga Gjkata Themelore në Gjilan.

Lidhur me leximin dhe administrimin e provave palët ndërgjyqëse nuk kanë vërejtje, nuk kanë provat tjera për ti dorëzuar kësaj gjykate, që kishin me ndikuar në zgjidhjen e çështjes kontestuese dhe janë lexuar të gjitha provat nga lënda.

Paditësi Sh. K., nga Gj në fjalën përfundimtare, deklaroi se qëndroj pran padisë-kërkespadi dhe i propozoi gjykatës që në tërësi ta aprovoi kërkespadinë si të bazuar. Nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

E paditura, Ministria për infrastrukturë, në Prishtinë, e përfaqësuar prej avokates shterore, .., në fjalën përfundimtare deklaroi në mungesë të provave, i propozoi gjykatës që kërkespadinë e paditësit ta rrefuzoi në tërësi si të pa bazuar. Nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

E paditura, NN „B.B., me seli në Gj sipas të autorizuarit, R. K jurist, nga Gj, në fjalën përfundimtare, deklaroi në mungesë të provave e i propozoi gjykatës që kërkespadinë e paditësit ta rrefuzoi në tërësi si të pa bazuar. Nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Gjkata pasi i ka lexuar dhe administruar, me kujdes në relacionin krahasues, të gjitha provat në hollësi veç e veç, e ka arritur qëndrimin juridik dhe e ka konstatuar gjendjen faktike si vijoi:

Se paditësi me as një provë valide, nuk ka mundur ta vërtetoi themlisinë e kërkespadinë dhe për këtë gjykata kërkespadinë e paditësit e ka rrefuzuar në tërësi si të pabazuar.

Nga të cekurat më lart gjykata konstatoi se palët ndërgjyqëse përkatësisht paditësi nuk ka dorëzuar prova materiale dhe valide për ta vërtetuar themlisinë e kërkespadi dhe për këtë gjykata e ka rrefuzuar në tërësi kërkespadinë e paditësit si të pabazuar.

Nga të cekuar më lart në bazë të nenit 143 të LPK-ës, gjykata vendosi që kërkespadi e paditësit, Shemsedin Kryeziu, nga Gjilani, për kompensimin e dëmit, në mungesë të provave në tërësi të refuzohet si e pa bazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës në bazë të nenit 450 të LPK-ës, gjykata vendosi që sejcila palët ti bartë shpenzimet e vata të procedurës kontestimore.

## **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Gj y q t a r i**  
Mr.sc. Halil Zahiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankese Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15.ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftuara përmes kësaj gjykate.

